



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

PËR PËRMBAJTJEN E KONTRATËS DHE TË PROSPEKTIT TË FONDIT TË PENSIONIT

Miraturar me Vendim Bordi nr.2, datë 13.01. 2011

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregulla më të hollësishme të përmbajtjes të kontratës dhe prospektit të fondit të pensionit vullnetar.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të dispozitave të nenit 9, paragrafi 4 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Mbi fondet e pensionit vullnetar”, këtu e më poshtë (“Ligji”).

Neni 3

Përmbajtja e kontratës të fondit të pensionit

Përveç kërkesave që përcaktohen në Ligj, kontrata duhet të përfshijë edhe të dhënat e mëposhtme për anëtarin, për punëdhënësin, fondin dhe depozitarin:

1. Për anëtarin e fondit të pensionit: emri dhe mbiemri, vendbanimi i përhershëm dhe/ose i përkohshëm, data e lindjes, shtetësia, numri i kartës së identitetit për shtetasit shqiptarë dhe/ose numri i pasaportës për shtetasit e huaj;
2. Për punëdhënësin: emri, adresa e selisë dhe numri i regjistrimit në QKR;
3. Për depozitarin: emrin e shoqërisë, formën ligjore, selinë dhe adresën depozitarit, si dhe numrat dhe të dhënat për licencat përkatëse nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti për kryerjen e veprimtarisë;
4. Për fondin e pensionit: emrin numrin dhe data e miratimit të licencës së administrimit të tij;
5. Mënyrat dhe afatet e njoftimit të gjendjes në llogarinë individuale të anëtarit të fondit;

6. Detyrimin e shoqërisë administruese për informimin dhe mënyrën e informimit të anëtarëve të fondit mbi ndryshimet në politikën e investimeve, si edhe rregullave të tjera të veprimtarisë që ndikojnë tek të ardhurat e anëtarëve të fondit;
7. Përcaktimin se mosvazhdimi i pagesave të pensionit:
 - a) nuk nënkupton ndërprerjen e anëtarësimit në fond;
 - b) anëtari i fondit nuk penalizohet në rast se pushon së paguari kontribute në fond.
8. Detyrimin e anëtarit të fondit për të paguar tarifë të administrimit në favour të shoqërisë administruese;
9. Detyrimin e anëtarit të fondit për të paguar shpenzimet e transferimit të llogarisë, shpenzime që mund të lidhen me kërkesa shtesë të njoftimit të gjendjes së llogarisë individuale.

Neni 4 Deklarata

Kontrata duhet të përmbajë një paragraf ku përfshihet deklarata e personit që anëtarësohet në fond, nëpërmjet të cilit ai konfirmon se ka kuptuar dhe pranuar prospektin dhe tarifat që aplikohen.

Neni 5 Kontrata

Kontrata duhet të jetë e njëjtë për të gjithë anëtarët e një fondi. Një model i kësaj kontrate duhet të depozitohet në Autoritet si dhe të vendoset në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

Neni 6 Përmbajtja e prospektit

1. Përveç kërkesave që përcaktohen në Ligj, prospekti duhet të përfshijë në hyrje të tij:
 - a) datën e publikimit;
 - b) deklarimin që organizimi dhe administrimi i fondit të pensionit kryhet ekskluzivisht nga shoqëria administruese e fondit të pensionit;
 - c) deklarimin që asetet e fondit janë tërësisht të ndara prej asetëve të tjera të administruara nga shoqëria administruese.
2. Përveç kërkesave që përcaktohen në Ligj, prospekti do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme për fondin:
 - a) datën e fillimit të veprimtarisë së fondit, që nënkupton datën e publikimit të vlerës së kuotës së parë të investuar, ose datën e publikimit të prospektit të parë;
 - b) drejtimit kryesor të politikës së investimeve të fondit dhe rregullat e administrimit të rrezikut ku përfshihen:

- (i) shpjegimi i termave që lidhen me politikën e investimeve;
 - (ii) rregullat e administrimit të rrezikut;
 - (iii) përqindja maksimale dhe/ose minimale e aseteve të fondit që mund të investohen në lloje të ndryshme letrash me vlerë, depozita bankare, në përputhje me politikën e investimeve të shoqërisë administruese;
 - (iv) procedura për vendimmarrjen e investimeve;
 - (v) procedura se si mund të ndryshojë politika e investimit dhe shpjegimi i qartë mbi procedurat dhe afatet e njoftimit të anëtarëve të fondit mbi ndryshimet në politikën e investimit;
- c) të ardhurat historike neto të fondit, të paraqitura me shifra dhe grafikisht, duke përfshirë edhe shënimin që niveli i të ardhurave neto nuk është i garantuar;
 - ç) të dhëna mbi nivelin e tarifave të aplikuara nga shoqëria administruese e fondit, dhe nivelin e shpenzimeve, së bashku me shpjegimin për llojet e tarifave dhe shpenzimeve dhe mënyrat e llogaritjes së tyre;
 - d) të drejtat dhe përgjegjësitë e shoqërisë administruese të fondit dhe anëtarëve të fondit në rast të transferimit të aseteve të llogarisë individuale në një fond tjetër;
- dh) kërkesat që duhet të plotësohen nga anëtari i fondit për të përfituar të drejtën e tërheqjes së fondeve të akumuluar në llogarinë e tij, si edhe periudhën kohore më të shkurtër që mund të zbatohet në kontratë për tërheqjen e pagesave periodike;
- e) mënyrën dhe afatet e kryerjes së pagesave nga shoqëria administruese.
3. Prospekti duhet të përmbajë një kapitull të vecantë me të dhënat aktuale mbi fondin, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur, të dukshme dhe të qartë:
- a) vlerën e aseteve neto të fondit;
 - b) nivelin e tarifave të ngarkuara për shërbimet e kryera nga shoqëria administruese;
 - c) shumën minimale të kontributit të pensionit;
 - ç) strukturën aktuale të aseteve të fondit, ndarjen në përqindje sipas tipeve të investimeve: letra me vlerë, depozita bankare, etj., së bashku me kufijtë e investimeve që zbatohen për tipet e investimeve.
4. Prospekti gjithashtu duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për shoqërinë administruese të fondit:
- a) emrin e shoqërisë dhe formën ligjore, selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore, nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar, numrin e licencës të dhënë nga Autoriteti, si dhe datën e themelimit e të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - b) nëse shoqëria administruese administron sipërmarrje të tjera të investimeve, një listë të këtyre sipërmarrjeve;
 - c) emrat e anëtarëve të këshillit të administrimit, CV e tyre të shkurtra dhe të dhëna treguese, nëse kanë, ose në ndonjë mënyrë, janë palë të lidhura me njëri-tjetrin;
 - ç) shumën e kapitalit të regjistruar të shoqërisë administruese dhe emrat e aksionarëve të shoqërisë administruese, formën ligjore dhe pjesëmarrjen e aksionarëve në kapitalin e regjistruar.
 - d) të dhëna mbi ekspertin kontabël të shoqërisë administruese.

5. Prospekti duhet të përmbajë informacion për depozitarin, që përfshin emrin e shoqërisë, formën ligjore, selinë dhe adresën depozitarit, numrin dhe të dhënat për licencat përkatëse nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti për kryerjen e veprimtarisë.

Neni 7

Kërkesa mbi prospektin

1. Prospekti duhet të jetë i shkruar në gjuhë të qartë dhe duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm.
2. Prospekti nuk duhet të përmbajë të dhëna të pavërteta, ose të dhëna që çojnë në gjykime të pavërteta, ose të gabuara për fondin, shoqërinë e administrimit ose sistemin e pensioneve.
3. Prospekti mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera që shoqëria administruuese e fondit i shikon si të dobishme për të dhënë një pasqyrë më të mirë për fondin dhe sistemin e pensioneve.
4. Prospekti publikohet në gjuhën shqipe dhe i shpërndahet falas anëtarëve aktualë dhe/ose atyre potencialë, si dhe të publikohet në faqen e internetit të shoqërisë administruuese.
5. Shoqëria administruuese mund të publikojë edhe një prospekt të thjeshtëzuar i cili do përmbajë një informacion koncis për shoqërinë administruuese. Prospekti i thjeshtëzuar shkruhet në një mënyrë që të kuptohet lehtë nga investitori i zakonshëm dhe duhet të përfshijë edhe një deklaratë të qartë dhe të hollësishme për ekzistencën e prospektit të plotë, i cili mund të sigurohet pas një kërkesë.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI